



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVO-KOMUNISTIKA MALISHEVO



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 04/07/2023
PRIMLJENO:
Mr. No. Rr. 01/923.

NGA: Zyra për Informim Publik

PËR: Kryetarin e Komunës, Ekrem Kastrati

LËNDA: Raporti i Punës gjashtëmujore

DATË: Qershor, 2023

Detyrat e dhëna:

- 1. Përcjellja e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve, komiteteve dhe organizmave tjerë komunal.**
- 2. Informimi i medieve për vendimet e marra në Kuvend dhe Këshill të Drejtorëve**
- 3. Udhëheqja e shërbimit të informimit publik.**
- 4. Informimi i organeve komunale, lidhur me shkrimet në media**
- 5. Reagimi ndaj shkrimeve tendencioze.**
- 6. Përgatitja e Buletinit mujor dhe vjetor, lidhur me informacionet dhe ngjarjet që kanë ndodhur gjatë muajit dhe vitit në komunën tonë.**
- 7. Mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare të komunës.**
- 8. Punë dhe obligime të tjera në bashkëpunim me udhëheqësit komunal.**
- 9. Informimi paraprak për ngjarjet në komunë.**

- Nga obligimet dhe takimet e shënuara në detyrat e dhëna, kemi përgatitur informacione për medie, dhe pothuajse të gjitha janë publikuar në mediet elektronike dhe të shkruara, përfshirë radio dhe televizionet lokale TV Malisheva dhe RTV Malisheva, Radio "Kosova e Lirë", radiotelevizionin publik, televizionet tjera dhe portalet informative.

- Po ashtu, të gjitha informacionet janë bërë publike edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Malishevës: <http://kk.rks-gov.net/malisheve/> , si dhe në rrjetet sociale.

- Një punë tjetër e Zyrës për Informim Publik, është ruajtja e artikujve të botuar në gazetatat ditore, për të cilat, çdo drejtor apo zyrtar komunal, mund ti shfletoj në Zyrën për Informim, por edhe të ketë kopje të tyre.

- Në mënyrë të rregullt përgatitet Buletini Mujor, gjashtëmujor dhe ai Vjetor, i cili është i publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, si dhe arkivohet në arkivin e komunës.

- Për të gjitha aktivitetet mujore, informohen mediet dhe njoftime bëhen publike në ueb faqet zyrtare.

Aktivitetet dhe publikimet

Gjatë periudhës janar - qershor 2023, janë zhvilluar 408 aktivitete të ndryshme, ku përfshihen përcjellja e aktiviteteve të kryetarit, drejtorëve komunal dhe zyrtarëve tjerë. Prej këtyre aktiviteteve, janë aktivitete të kryetarit dhe qeverisë komunale, ku përfshihen takimet në zyrat përkatëse, vizita në terren, takime me qytetarë dhe të tjera, ku janë **bërë 133 lajme, 24 njoftime, 45 shpallje dhe konkurse 26, 6 buletin (Janar- Qershor 2023), si dhe janë publikuar dokumente ku përfshihen, kontratat, 16 plane pune dhe 6 raporte pune, 3 Rregullore, dhe 48 vendime të kryetarit, 68 vendime të Kuvendit të Komunës, 3 procesverbale të KK, mbledhje të kuvendit, 5 të rregullta, 2 solemne, të jashtëzakonshme, 1 urgjente, 12 procesverbale të Komitetit për Politikë, mbledhje të rregullta 2 dhe 1 urgjente, të jashtëzakonshme, 1 konsultime publike, 1 debat me qytetarë, në mënyrë elektronike i kemi pranuar pyetjet e qytetarëve dhe u kemi përgjigjur po ashtu dëgjimet publike të kryetarit, kurse, drejtorisë për buxhet dhe financa, rregulloreve me pjesëmarrje të grupeve të interesuara, 12 kërkesa në Qasjen për Dokumente Publike, prononcime publike për medie nga zyrtari për informim, e po ashtu edhe nga kryetari i komunës, aktivitete të komiteteve dhe komisioneve janë përcjellë dhe aktivitete tjera, vizita në terren, takime zyrtare dhe të tjera. Të Enjten, pritja e palëve, janë përfshirë deklaratimet për medie dhe reagimet e ndryshme që i ka bërë Zyra për Informim.**

Bazuar në këto të dhëna, Zyra për Informim Publik, ka kryer më shumë se shtatë aktivitete të ndryshme, brenda një dite, pa e llogaritur këtu edhe daljet në terren dhe punën jashtë orarit. Sipas nevojës, është punuar edhe jashtë orarit të punës, përfshi edhe ditët e vikendit apo ditët e festave zyrtare.

Gjithashtu, ueb faqja e Komunës së Malishevës, është freskuar në vazhdimësi, sidomos linqet e lajmeve, njoftimeve dhe publikimi i dokumenteve, sipas nevojave dhe kërkesave të zyrave përkatëse.

Malishevë, 3 korrik 2023

Zyra për Informim Publik